



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
SPORTIT DHE RINISË  
MINISTRI

Nr. 13341 Prot.

Tiranë, më 29.12.2017

UDHËZIM

Nr. 32, datë 29.12 2017

PËR

**"DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.17, DATË 03.08.2016 "PËR PROCEDURAT DHE KRITERET PËR NJOHJEN DHE NJËSIMIN NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, TË DIPLOMAVE, CERTIFIKATAVE, GRADAVE SHKENCORE DHE TITUJVE AKADEMIKË TË LËSHUARA NGA INSTITUCIONET E HUAJA TË ARSIMIT TË LARTË DHE INSTITUCIONE TË TJERA TË AUTORIZUARA, JASHTË VENDIT"**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 92 të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 17, datë 03.08.2016 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit "Për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucionet e tjera të autorizuara, jashtë vendit", bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Në Pikën 1 të Kreut III, germa "d", ndryshon si më poshtë vijon:

*"d) Fotokopje e kartës së identitetit ose të pasaportës (vetëm për shtetasit e huaj)."*

2. Në pikën 2 të Kreut III, germat "c", "d", "e" dhe "f", shfuqizohen.

3. Në pikën 2 të Kreut III, germa "g", ndryshon si më poshtë :

*"g) Fotokopje e kartës së identitetit ose të pasaportës (vetëm për shtetasit e huaj)."*

4. Në pikën 3 të Kreut III, germat "d", "f" dhe "i", shfuqizohen.

5. Në pikën 3 të Kreut III, germa "g", ndryshon si më poshtë :

*“g) Fotokopje e kartës së identitetit ose të pasaportës (vetëm për shtetasit e huaj).”*

6. Në pikën 3 të Kreut III, pika “iii”, në germën “h”, ndryshon si më poshtë :

*“iii. Botime të punimeve shkencore në organe shkencore ndërkombëtare.”*

*Ky Udhëzim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.*

**LINDITA NIKOLLA**  
  
**MINISTËR**

